



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

 01  110/04-24669
Nr./Br. 110/04-24669
Data/Datum 31.10.2022
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

RREGULLORE PËR TAKSA KOMUNALE

Gjakovë 2022



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2022

Datë: 26.10.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), të nenit 18. 2 shkronja (a) e Statuti të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.10.2022 pas diskutimeve lidhur me pikën e 14 të rendit të ditës: Kërkesa e Ministrisë së Shëndetësi për Rishqyrtimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 nr.011/01-19340 të dt. 28.07.2022, e miratoj këtë :

**RREGULLORE
PËR TAKSA KOMUNALE**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Gjakovës, lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruar nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1 Taksë komunale – nënkupton shumën fikse dhe të pakthyeshme të pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të nxjerrjes së:
 - 1.1.1 Certifikatat dhe dokumentet tjera përkatëse të lëshuara nga Komuna;
 - 1.1.2 Shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;

- 1.1.3 Ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;
- 1.1.4 Pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;
- 1.1.5 Ndërtimit, rrënitit të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës dhe
- 1.1.6 Shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.
- 1.2 Taksa qendrore – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mbliidhen nga Komuna;
- 1.3 Vit fiskal – nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) dhjetor të të njëjtit vit;
- 1.4 Gjobë – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridik dhe fizik për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje;
- 1.5 Person – nënkupton personin fizik dhe juridik;
- 1.6 Person fizik – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi, ndërsa personi fizik afarist nënkupton personin që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;
- 1.7 Person juridik – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;
- 1.8 Pano reklamuese – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës;
- 1.9 Shoqëri Tregtare – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

KAPITULLI II KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë akt tjetër juridik.
2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo ndonjë akt tjetër juridik, nuk mund të kërkohet që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.

5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskeve elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimi.

Neni 6 **Lirimet nga taksat komunale**

1. Të gjitha kategoritë e liruar nga pagesa e taksave komunale përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj lirim nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj lirim nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedurë ku kërkohet pagesa e taksave komunale, është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa.

KAPITULLI III **TAKSA KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE** **ZYRTARE**

Neni 7 **Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare**

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:
 - 1.1 Certifikata e lindjes – një euro (1 €);
 - 1.2 Ekstrakti i lindjes - një euro (1 €);
 - 1.3 Certifikata e shtetësisë - një euro (1 €);
 - 1.4 Certifikata e martesës - një (euro 1 €);
 - 1.5 Certifikata e vendbanimit apo e vendqëndrimit - një euro (1 €);
 - 1.6 Certifikata e gjendjes martesore - një euro (1 €);
 - 1.7 Certifikata e vdekjes - një euro (1 €);
 - 1.8 Certifikata e bashkësisë familjare - një euro (1 €);
 - 1.9 Certifikata mbi vërtetimin e arkivit – tre euro (3 €)
 - 1.10 Akti i vdekjes - pesë euro (5 €);
 - 1.11 Vërtetim mbi mjetet e jetesës - dy euro (2 €);
 - 1.12 Vërtetim që personi është në jetë - një euro (1 €);
 - 1.13 Vërtetim për lajmërim apo ç ‘lajmërimin e vendbanimit – Pa pagesë;
 - 1.14 Vërtetimi që personi nuk është regjistruar në regjistrat civil – Pa pagesë
 - 1.15 Pranimi i kërkesave dhe ankesave – një euro (1 €);
2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimi të certifikatës apo dokumenteve zyrtare. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të merret certifikata apo dokumenti zyrtar
3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni Komuna lëshon dëshminë përkatëse dhe ky vërtetim është i vlefshëm brenda gjithë vitit fiskal, në rast se kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesë së taksës.

Neni 8

Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare janë të liruara kategoritë si në vijim:
 - 1.1 Veteranët e luftës;
 - 1.2 Invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së;
 - 1.3 Personat e verbër;
 - 1.4 Personat paraplegjik dhe tetraplegjik; dhe
 - 1.5 Përfituesit e skemave sociale.

Neni 9

Detyrimi lidhur me të dhënat

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e parapara nga nën paragrafi 1.1 deri te nën paragrafi 1.8 të paragrafit 1 të nenit 7 kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor
2. Të gjitha personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga nënparagrafi 1.9 deri te 1.15 të nenit 7 kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

KAPITULLI IV

TAKSAT KOMUNALE ADMINISTRATIVE

Neni 10

Lartësia dhe pagesa e taksave komunale administrative

1. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:
 - 1.1. Kurorëzimi brenda objektit të komunës, brenda orarit të punës – dhjetë euro (10 €);
 - 1.2. Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës – njëzetë euro (20 €);
 - 1.3. Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës – njëzetepesë euro (25 €);
 - 1.4. Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës – pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.5. Korrigjimi emrit personal (germëzimi) – tri euro (3 €)
 - 1.6. Ndryshimi i emrit personal – pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.7. Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës pesë euro (5 €);
 - 1.8. Anulimi i dyfishtë i regjistrimit në gjendjen civile pesë euro (5 €);
 - 1.9. Kërkesa për procesverbale të ndryshme - pesë euro (5 €);
 - 1.10. Legalizimi i dokumenteve në bazë të origjinalit (për një faqe) – pesëdhjetë cent (0.50€);
 - 1.11. Lëshimi i vërtetimit për gjendjen e tatimit në pronë – dy euro (2 €);
 - 1.12. Leja mbi varrimin – Pa pagesë;
 - 1.13. Inspektimi final në fushën e ndërtimit për personat fizik dhe juridik – dhjetë euro (10 €)
 - 1.14. Kërkesa për mbikëqyrje të asgjësimit të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore deri në 1500 kg/litër njëzetepesë euro (25 €), mbi 1500 kg/litër është pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.15. Lëshimi i certifikatës së përdorimit – Pa pagesë;
 - 1.16. Lëshimi i pëlqimit urbanistik dhe dokumenteve tjera urbanistike – dhjetë euro (10 €);
 - 1.17. Lëshimi i vërtetimit mbi statusin ushtarak – pesë euro (5 €);
 - 1.18. Pajisja me Certifikatë/pëlqim sanitar në fushën e ndërtimit: Për 1 deri 100 m² -njëqind euro (100 €), Pagesa për 101 deri 1000 m² – pesëqind euro (500 €), Pagesa për 1001 deri 2000 m² - njëmijë 1000 euro (1000 €), Pagesa për mbi 2000 m² – dymijë euro (2000 €).
 - 1.19. Certifikatë që nuk është nën kujdestari (për mbajtje të armës) – pesë euro (5 €);

- 1.20. Vërtetim për lirim nga shtetësia e Republikës së Kosovës – dhjetë euro (10 €);
- 1.21. Vërtetimin për pranimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës - pesë euro (5 €);
- 1.22. Vërtetim për Bashkim Familjar (Anamnezë Sociale) - dhjetë euro (10 €);
- 1.23. Vërtetim që personi nuk është shfrytëzues i asistencës sociale – tre euro (3 €);
- 1.24. Kërkesa nga palët për vlerësimin e dëmit – Pesë euro (5€);

2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të shërbimit komunal. Shërbimi nuk ofrohet pa dëshmi të pagesës.

Neni 11

Lirimet nga pagesa e taksave komunale administrative

1. Nga pagesat e taksës komunale administrative janë të liruar kategoritë si në vijim:
 - 1.1. Veteranët e luftës;
 - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së;
 - 1.3. Personat e verbër;
 - 1.4. Personat paraplegjik dhe tetraplegjik; dhe
 - 1.5. Përfituesit e skemave sociale.

KAPITULLI V

TAKSA KOMUNALE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE

Neni 12

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda territorit të Komunës, paguan taksë vjetore komunale siç është e pëcaktuar në pikat e mëposhtme. Për paisjen me dokumentet përkatëse të lëshuara nga organet komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, taksohet si në vijim:
 - 1.1. Gjuetia, vënia e pusive dhe aktivitetet tjera shërbyese – Pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.2. Kulturat pyjore dhe aktivitetet e tjera të pylltarisë - Pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.3. Prerja e drunjëve-trungjeve - Pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.4. Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve - Pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.5. Peshkimi i ujërave të ëmbla – pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.6. Akuakultura e ujërave të ëmbla – pesëdhjetë euro (50 €);
 - 1.7. Nxjerrja e qymyrit të fortë – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
 - 1.8. Nxjerrja e linjiteve - njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
 - 1.9. Nxjerrja e naftës së papërpunuar – treqind euro (300 €)
 - 1.10. Nxjerrja e xehes së hekurit - treqind euro (300 €);
 - 1.11. Nxjerrja e xeheve të uraniumit dhe toriumit - treqind euro (300 €);
 - 1.12. Nxjerrja e xeheve tjera jo-metallore - treqind euro (300 €);
 - 1.13. Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave - treqind euro (300 €);
 - 1.14. Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinit - pesëqind euro (500 €);
 - 1.15. Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehrave kimik - treqind euro (300 €);
 - 1.16. Nxjerrja e troftës – njëqind euro (100 €);
 - 1.17. Nxjerrja e kripës - njëqind euro (100 €);
 - 1.18. Aktivitetet tjera nxjerrëse dhe gurëthyese p.k.t. - pesëqind euro (500 €);
 - 1.19. Aktivitetet mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror treqind euro (300 €);

- 1.20. Aktivitetet mbështetëse për minierat dhe gurëthyesit tjerë – dyqind euro (200 €);
- 1.21. Përpunimi dhe konservimi i mishit - njëqind euro (100 €);
- 1.22. Procesimi dhe konservimi i mishit të shpezëve - njëqind euro (100 €);
- 1.23. Prodhimi i mishit dhe i produkteve të mishit të shpezëve - njëqind euro (100 €);
- 1.24. Përpunimi dhe konservimi i peshqve, kurstaceve dhe molusqeve - njëqind euro (100 €);
- 1.25. Përpunimi dhe konservimi i patateve - njëqind euro (100 €);
- 1.26. Përpunimi i lëngjeve të frutave dhe perimeve – njëqind euro (100 €);
- 1.27. Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve - njëqind euro (100 €);
- 1.28. Përpunimi i vajrave dhe yndyrave – njëqind euro (100 €)
- 1.29. Prodhimi i gjalpës dhe yndyrave të ngjashme - njëqind euro (100 €);
- 1.30. Operimi i përgatitjes së prodhimeve qumështore dhe djathit – njëqind euro (100 €);
- 1.31. Prodhimi i akullores – tetëdhjetë euro (80 €)
- 1.32. Prodhimi i produkteve të miellit të drithit – njëqind euro (100 €);
- 1.33. Prodhimi i niseshteve dhe i produkteve të saja – njëqind euro (100 €)
- 1.34. Prodhimi i bukës, i simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta – tetëdhjetë euro (80 €);
- 1.35. Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar – njëqind euro (100€);
- 1.36. Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli – njëqind euro (100 €);
- 1.37. Prodhimi i sheqerit – njëqind euro (100 €);
- 1.38. Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe të ëmbëlsirave – njëqind euro (100 €);
- 1.39. Përpunimi i çajit dhe i kafes – nëntëdhjetë euro (90 €);
- 1.40. Përpunimi i erëzave dhe salcave – nëntëdhjetë euro (90 €);
- 1.41. Përpunimi i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme - njëqind euro (100 €);
- 1.42. Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike - njëqind euro (100 €);
- 1.43. Përpunimi i produkteve tjera ushqimore p.k.t. – njëqind euro (100 €);
- 1.44. Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës – njëqind euro (100 €);
- 1.45. Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake – njëqind euro (100 €);
- 1.46. Distilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.47. Prodhimi i verës nga rrushi – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.48. Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash- njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.49. Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padestiluara – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.50. Prodhimi i birrës – dyqind euro (200 €);
- 1.51. Prodhimi i majës së birrës - njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.52. Prodhimi i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit në shishe – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.53. Prodhimi i produkteve të duhanit – dyqind euro (200 €)
- 1.54. Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit - njëqind euro (100 €);
- 1.55. Prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura – shtatëdhjetë e pesë euro (75 €);
- 1.56. Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfesionuar përveç veshjeve - njëqind euro (100 €);
- 1.57. Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve - njëqind euro (100 €);
- 1.58. Prodhimi i litarëve, spangove, rrjetave - njëqind euro (100 €);
- 1.59. Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve – shtatëdhjetë e pesë euro (75 €);
- 1.60. Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale – shtatëdhjetë e pesë euro (75 €);
- 1.61. Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t. – shtatëdhjetë e pesë euro (75 €);
- 1.62. Prodhimi i veshjeve të lëkurës – njëqind euro (100 €);
- 1.63. Prodhimi i veshjeve të punës - njëqind euro (100 €);
- 1.64. Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme - njëqind euro (100 €);
- 1.65. Prodhimi i veshjeve të brendshme - njëqind euro (100 €);
- 1.66. Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.) - njëqind euro (100 €);
- 1.67. Prodhimi i artikujve nga gëzofi – njëqind euro (100)

- 1.68. Prodhimi i çorapeve të thurura - pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.69. Prodhimi i rrobave të thurura ose të punuara me grep - pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.70. Tanimi dhe regjia e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit- njëqind euro (100 €);
- 1.71. Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve - njëqind euro (100 €);
- 1.72. Prodhimi i këpucëve - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.73. Sharrimi i drurit dhe zdrukthëtaria - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.74. Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të panelave bazuar në dru (furniri) - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.75. Prodhimi i karpentiriesë dhe zdrukthëtarisë tjetër ndërtuese - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.76. Prodhimi i kontejnerëve nga druri - njëqind euro (100 €);
- 1.77. Prodhimi i produkteve tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse - njëqind euro (100 €);
- 1.78. Prodhimi i brumit të letrës- tetëdhjetë euro (80 €);
- 1.79. Prodhimi i letrës dhe kartonit - njëqind euro (100 €);
- 1.80. Prodhimi i letrës dhe kartonit të valëzuar, si dhe ambalazhit prej letre dhe kartoni - njëqind euro (100 €);
- 1.81. Prodhimi i artikujve prej letre me përdorim familjar dhe sanitar, letrës së tualetit - njëqind euro (100 €);
- 1.82. Prodhimi i materialit prej letrës për zyre - njëqind euro (100 €);
- 1.83. Prodhimi i tapetave të mureve - njëqind euro (100 €);
- 1.84. Prodhimi i artikujve të tjerë prej letrës dhe kartonit p.k.t - njëqind euro (100 €);
- 1.85. Shtypja e gazetave - pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.86. Shtypje (printime) tjera - pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.87. Shërbimet e përgatitjeve para-shtypjes dhe para-publikimit - njëqind euro (100 €);
- 1.88. Libërlidhja dhe shërbime të ngjashme - pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.89. Riprodhimi i mediave të incizuara - njëqind euro (100 €);
- 1.90. Prodhimi i produkteve të furrës së kokosit - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.91. Prodhimi i produkteve të rafinuara të naftës - treqind euro (300 €);
- 1.92. Prodhimi i gazrave industriale - treqind euro (300 €);
- 1.93. Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.94. Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.95. Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.96. Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit - dyqind euro (200 €);
- 1.97. Prodhimi i plastikës në formë primare - dyqind euro (200 €);
- 1.98. Prodhimi i gomës sintetike në formë primare - dyqind euro (200 €);
- 1.99. Prodhimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera agrokimike - dyqind euro (200 €);
- 1.100. Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës- dyqind euro (200 €);
- 1.101. Prodhimi i sapunit, detergjentëve dhe produkteve të pastrimit, si dhe preparateve për shkëlqim - njëqind euro (100 €);
- 1.102. Prodhimi i parfumeve dhe preparateve të tualetit - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.103. Prodhimi i eksplozivëve - treqind euro (300 €);
- 1.104. Prodhimi i ngjitësve - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.105. Prodhimi i vajrave esencial - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.106. Prodhimi i produkteve tjera kimike p.k.t. - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.107. Prodhimi i fibrave sintetikë dhe artificial - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.108. Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike - dyqind euro (200 €);
- 1.109. Prodhimi i preparateve farmaceutike - dyqind euro (200 €);
- 1.110. Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; rimbushja e riparimi i gomave - dyqind euro (200 €);
- 1.111. Prodhimi i produkteve tjera të gomës - dyqind euro (200 €);
- 1.112. Prodhimi i pllakëzave të plastikës, fletëzave, tubave dhe profileve - dyqind euro (200 €);

- 1.113.Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim – njëqind euro (100 €);
- 1.114.Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.115.Prodhimi i produkteve të tjera të plastikës – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.116.Prodhimi i qelqit të rrafshët – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.117.Formësimi dhe përpunimi i qelqit të rrafshët – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.118.Prodhimi i qelqit bosh (i zbrazët) – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.119.Prodhimi i fibrave të qelqit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.120.Prodhimi dhe përpunimi i produkteve të tjera prej qelqi duke përfshirë edhe mallrat teknike prej qelqi – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.121.Prodhimi i produkteve rezistente ndaj zjarrit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.122.Prodhimi i tullave dhe tjegullave prej qeramike – dyqind euro (200 €);
- 1.123.Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur – treqind euro (300 €);
- 1.124.Prodhimi i produkteve të qeramikës për përdorim shtëpiak dhe zbukurues – njëqind euro (100 €);
- 1.125.Prodhimi i pajisjeve sanitare prej qeramikës – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.126.Prodhimi i izolatorëve prej qeramikës dhe pajisjeve izoluese – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.127.Prodhimi i produkteve të tjera teknike prej qeramike – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.128.Prodhimi i produkteve të tjera prej qeramike – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.129.Prodhimi i çimentos – dyqind euro (200 €);
- 1.130.Prodhimi i gëlqeres dhe llaçit – dyqind euro (200 €);
- 1.131.Prodhimi i produkteve prej betoni për qëllime ndërtimi – dyqind euro (200 €);
- 1.132.Prodhimi i produkteve prej llaçi për qëllime ndërtimi – dyqind euro (200 €);
- 1.133.Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim – dyqind euro (200 €);
- 1.134.Prodhimi i llaçeve – dyqind euro (200 €);
- 1.135.Prodhimi i fibrave të çimentos – dyqind euro (200 €);
- 1.136.Prodhimi i produkteve tjerë prej betoni, çimento dhe llaçi – dyqind euro (200 €);
- 1.137.Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare – njëqindenjëzet euro (120 €);
- 1.138.Prodhimi i produkteve gërryese – njëqindenjëzet euro (120 €);
- 1.139.Prodhimi i produkteve minerale jometalike p.k.t. – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.140.Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe ferrolegurave – dyqind euro (200 €);
- 1.141.Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve tjera nga çeliku – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.142.Tërheqja në të ftohtë e shufrave – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.143.Mbështjellja e ftohtë e rripave të ngushtë – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.144.Formimi ose palosja e ftohtë – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.145.Tërheqja e ftohtë e telit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.146.Prodhimi i metaleve të çmuara – dyqind euro (200 €);
- 1.147.Prodhimi i aluminit – dyqind euro (200 €);
- 1.148.Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit – dyqind euro (200 €);
- 1.149.Prodhimi i bakrit – dyqind euro (200 €);
- 1.150.Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike – dyqind euro (200 €);
- 1.151.Derdhja (fonderia) e hekurit – dyqind euro (200 €);
- 1.152.Derdhja (fonderia) e çelikut – dyqind euro (200 €);
- 1.153.Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta – dyqind euro (200 €);
- 1.154.Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera jo-ferrike – dyqind euro (200 €);
- 1.155.Prodhimi i konstruksioneve metalike dhe pjesëve të tyre – dyqind euro (200 €);
- 1.156.Prodhimi i dyerve dhe dritareve prej metali – dyqind euro (200 €);
- 1.157.Prodhimi i radiatorëve dhe i kazanëve për ngrohje qendrore – dyqind euro (200 €);
- 1.158.Prodhimi i tankerëve, rezervuarëve dhe kontejnerëve tjerë prej metali – dyqind euro (200 €);
- 1.159.Prodhimi i gjeneratorëve me avull, përveç kazanëve për ngrohje qendrore – dyqind euro (200 €);

- 1.160. Prodhimi i armëve dhe municionit – treqind euro (300 €);
- 1.161. Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve: pluhuri metalurgjik – dyqind euro (200 €);
- 1.162. Trajtimi dhe veshja e metaleve – dyqind euro (200 €);
- 1.163. Përpunimi mekanik – njëqind euro (100 €);
- 1.164. Prodhimi i artikujve prerës (thikë, pirun etj.) – tetëdhjetë euro (80 €);
- 1.165. Prodhimi i bravave dhe cilindrave – njëqind euro (100 €);
- 1.166. Prodhimi i veglave – njëqind euro (100 €);
- 1.167. Prodhimi i kovave të çelikta dhe mbajtësve të ngjashëm – njëqind euro (100 €);
- 1.168. Prodhimi i ambalazheve prej metali të lehtë – njëqind euro (100 €);
- 1.169. Prodhimi i produkteve prej teli, zinxhiri dhe suste – njëqind euro (100 €);
- 1.170. Prodhimi i vidave dhe kaçavidave – njëqind euro (100 €);
- 1.171. Prodhimi i produkteve tjera metalike p.k.t. – njëqind euro (100 €);
- 1.172. Prodhimi i komponentëve elektronikë – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.173. Prodhimi i pllakëzave të integruara elektronike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.174. Prodhimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.175. Prodhimi i pajisjeve të komunikimit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.176. Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorë – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.177. Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve të matjes, testimit, verifikimit dhe navigimit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.178. Prodhimi i pajisjeve për rrezatim, elektromjekësore dhe elektroterapeutike – dyqind euro (200 €);
- 1.179. Prodhimi i orëve të dorës dhe të murit – njëqind euro (100 €);
- 1.180. Prodhimi i instrumenteve optike dhe pajisjeve fotografike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.181. Prodhimi i mjeteve optike dhe magnetike të komunikimit – dyqind euro (200 €);
- 1.182. Prodhimi i motorëve elektrik, gjeneratorëve dhe transformatorëve – dyqind euro (200 €);
- 1.183. Prodhimi i aparateve të shpërndarjes dhe kontrollit të energjisë elektrike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.184. Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.185. Prodhimi i kabllave të fibrave optik – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.186. Prodhimi i telave dhe kabllave të tjera elektrike dhe elektronike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.187. Prodhimi i pajisjeve elektroinstaluese – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.188. Prodhimi i pajisjeve elektrike të ndriçimit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.189. Prodhimi i pajisjeve elektrike shtëpiake – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.190. Prodhimi i pajisjeve jo elektrike shtëpiake – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.191. Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.192. Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç motorëve të aeroplanëve, automjeteve dhe motoçikletave – dyqind euro (200 €);
- 1.193. Prodhimi i pajisjeve hidraulike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.194. Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.195. Prodhimi i rubinetave dhe valvulave – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.196. Prodhimi i kushinetave, ingranazheve, grupeve të ingranazheve dhe elementeve të drejtimit – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.197. Prodhimi i furrave, furnaltave (kalldajave) dhe aparaturave për djegie – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.198. Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe zhvendosjes – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.199. Prodhimi i makinave llogaritëse dhe makinave të tjera – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.200. Prodhimi i veglave mekanike të dorës – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.201. Prodhimi i pajisjeve joshtëpiake për ftohje dhe ventiliim – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.202. Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të përgjithshëm p.k.t. – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.203. Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);

- 1.204. Prodhimi i makinerive për punimin e metaleve – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.205. Prodhimi i veglave të tjera të makinave p.k.t – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.206. Prodhimi i makinerive për metalurgjinë - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.207. Prodhimi i makinerive për miniera, gurëthyes dhe ndërtimtari – treqind euro (300 €)
- 1.208. Prodhimi i makinerive për përpunimin e ushqimeve, pijeve dhe duhanit – dyqind euro (200 €);
- 1.209. Prodhimi i makinerive për prodhimin e tekstileve, veshjeve dhe lëkurave- njëqind e pesëdhjetë (150 €);
- 1.210. Prodhimi i makinerive të industrisë së letrës dhe kartonit - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.211. Prodhimi i makinerisë së plastikës dhe gomës – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.212. Prodhimi i makinerive të tjera me përdorim të veçantë p.k.t. – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.213. Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit) – dyqind euro (200 €);
- 1.214. Prodhimi i karrocërve për mjetet motorike (të transportit): prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.215. Prodhimi i pjesëve elektrike dhe elektronike për mjetet motorike (të transportit) - njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.216. Prodhimi i pjesëve dhe aksesorëve të tjerë për mjetet motorike (të transportit) – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.217. Prodhimi i motoçikletave – njëqind euro (100 €);
- 1.218. Prodhimi i biçikletave dhe karrocave për persona me nevoja të veçanta – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.219. Prodhimi i mjeteve tjera të transportit p.k.t. – dyqind euro (200 €);
- 1.220. Prodhimi i mobilieve për zyra dhe dyqane – dyqind euro (200 €);
- 1.221. Prodhimi i mobilieve të kuzhinës – dyqind euro (200 €);
- 1.222. Prodhimi i dyshekëve – dyqind euro (200 €);
- 1.223. Prodhimi i mobilieve tjera – dyqind euro (200 €);
- 1.224. Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikujve të ngjashëm me to – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.225. Prodhimi i stolive imituese dhe artikujve të tjerë të ngjashëm – njëqind euro (100 €);
- 1.226. Prodhimi i instrumenteve muzikore - njëqind euro (100 €);
- 1.227. Prodhimi i artikujve sportiv – njëqind euro (100 €);
- 1.228. Prodhimi i lojërave dhe lodrave - pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.229. Prodhimi i instrumenteve mjekësore dhe dentare – njëqindepesëdhjetë euro (150 €);
- 1.230. Prodhimi i fshesave dhe furçave – njëqind euro (100 €);
- 1.231. Prodhimi tjetër p.k.t. – njëqind euro (100 €);
- 1.232. Riparimi i produkteve metalike të fabrikua – shtatëdhjetëpesë euro (75 €);
- 1.233. Riparimi i makinerisë – shtatëdhjetëpesë euro (75 €);
- 1.234. Riparimi i pajisjeve elektronike dhe optike – shtatëdhjetëpesë euro (75 €);
- 1.235. Riparimi i pajisjeve elektrike – shtatëdhjetëpesë euro (75 €);
- 1.236. Riparimi dhe mirëmbajtja e anijeve dhe barkave – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.237. Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera të transportit të p.k.t – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.238. Riparimi i pajisjeve të tjera p.k.t – njëqind euro (100 €);
- 1.239. Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale – njëqindepesëdhjetë euro (150 €)
- 1.240. Prodhimi i energjisë elektrike – katërqind euro (400 €);
- 1.241. Transmetimi i energjisë elektrike – katërqind euro (400 €);
- 1.242. Shpërndarja e energjisë elektrike – katërqind euro (400 €);
- 1.243. Tregtia e energjisë elektrike – katërqind euro (400 €);
- 1.244. Prodhim i gazit – treqind euro (300 €);
- 1.245. Shpërndarja e lëndëve djegëse të gazta përmes tubacioneve – treqind euro (300 €);
- 1.246. Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar – treqind euro (300 €);
- 1.247. Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë – pesëqind euro (500 €);
- 1.248. Kanalizimi – treqind euro (300 €);

- 1.249. Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €);
- 1.250. Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme – njëqind euro (100 €);
- 1.251. Riciklimi i mbeturinave dhe hudhjeve metalike – njëqind euro (100 €);
- 1.252. Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet tjera të menaxhimit të mbeturinave – njëqind euro (100 €);
- 1.253. Zhvillimi i projekteve të ndërtimit – dyqind euro (200 €);
- 1.254. Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore – treqind euro (300 €);
- 1.255. Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave – treqind euro (300 €);
- 1.256. Ndërtimi i hekurudhave mbi dhe nëntokësore – treqind euro (300 €);
- 1.257. Ndërtimi i urave dhe tuneleve – treqind euro (300 €);
- 1.258. Ndërtimi i projekteve të tubacioneve dhe kanalizimeve – treqind euro (300 €);
- 1.259. Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për energji eklektike dhe telekomunikacion – treqind euro (300 €);
- 1.260. Ndërtimi i projekteve të ujit – treqind euro (300 €);
- 1.261. Ndërtimi i projekteve tjera të ndërtimit civil p.k.t. – treqind euro (300 €);
- 1.262. Demolimi i objekteve – treqind euro (300 €);
- 1.263. Përgatitja e vendpunishtes – dyqind euro (200 €);
- 1.264. Testi i shpuarjes dhe shpuarja – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.265. Instalime elektrike – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.266. Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit – dyqind euro (200 €);
- 1.267. Instalime tjera ndërtimore – dyqind euro (200 €);
- 1.268. Punime suvatimi – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.269. Punime montimi nga druri dhe materiale tjera – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.270. Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.271. Lyerja dhe vendosja e xhamave – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.272. Përfundimi dhe finalizimi i punëve tjera të ndërtesave – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.273. Punimet e kulmit (çatisë) – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.274. Aktivitetet tjera të specializuara të ndërtimit p.k.t. – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.275. Tregtia e veturave dhe automjeteve të lehta motorike – dyqindpesëdhjetë euro (250 €);
- 1.276. Tregtia e automjeteve tjera – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.277. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve – njëqind euro (100 €);
- 1.278. Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.279. Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike – njëqind euro (100 €);
- 1.280. Tregtia, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre – njëqind euro (100 €);
- 1.281. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, lëndëve të para tekstile dhe artikujve gjysëm të gatshëm – njëqind euro (100 €);
- 1.282. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale – dyqind euro (200 €);
- 1.283. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndës së drurit dhe materialeve ndërtimore – dyqind euro (200 €);
- 1.284. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e makinerive, pajisjeve industriale, anijeve dhe aeroplanëve – dyqind euro (200 €);
- 1.285. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen mobilieve, artikujve shtëpiak, aparateve elektronike dhe hekurishteve – dyqind euro (200 €);
- 1.286. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, gëzofit, këpucëve dhe artikujve prej lëkure – dyqind euro (200 €);
- 1.287. Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit – dyqind euro (200 €);
- 1.288. Aktivitetet e ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta – dyqind euro (200 €);
 - 1.3 Për tokat bujqësore të klasës 7 deri 8 – pesëdhjetë cent për një metër katror (0.50€/m²);
2. Për ndërrimin e përkohshëm të tokës bujqësore aplikuesit paguajnë vetëm njëzetë për qind (20%) të vlerës së paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Taksa e paraparë në paragrafin një (1) dhe dy (2) të këtij neni paguhet para ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore dhe ky ndërrim nuk mund të realizohet pa e paguar këtë taksë.
4. Taksat e përcaktuara si në paragrafët një (1), dy (2) dhe tre (3) nuk aplikohen për institucionet publike siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi.
5. Shërbimet profesionale për prerjen e pyjeve private:
 - 5.1. Dru zjarri për m³ në shumë prej 1.50 €
 - 5.2. Dru zjarri mbi 7 m³ në shumë prej 2.00 €
 - 5.3. Dru teknike për m³ në shumë prej 3.00 €
6. Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave:

Lloji i bagëtisë	NB/kokë	EUR/kokë
Gjedhet mbi një vit	1	1.20
Viçat	0.45	0.54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0.12
Kuajt dhe gomarët	1	1.20
Dosat	0.5	0.60
Derrat	0.3	0.36
Rosat	0.014	0.02

7. Taksat e përcaktuara në këtë nen, nuk kanë fuqi juridike nëse me legjislacionin primar të aplikueshëm do të ndryshohen.

8. Taksat tjera në sektorin e bujqësisë që janë të përcaktuara me legjislacionin e kësaj fushe, do të inkasohen sipas tarifave të përcaktuara nga dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara nga institucionet qendrore.

KAPITULLI VIII

TAKSA KOMUNALE PËR SHFRYTËZIMIN E OBJEKTEVE, HAPËSIRËS DHE TË MIRAVE PUBLIKE

Neni 24

Taksa mbi vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese të dukshme dhe që kufizohet me hapësirë publike mbi 1m² në pronën e tij private apo të marrë në shfrytëzim apo me qira, paguan taksë vjetore, si në vijim:
 - 1.1 Për panot reklamuese deri në një metër katror (1m²) – Pa pagesë (00 €);
 - 1.2 Për panot reklamuese nga një metër katror (1m²) deri në dy metër katror (2m²) - njëzetë (20 €);
 - 1.3 Për panot reklamuese nga dy metër katror (2m²) deri në katër metër katror (4m²) - tridhjetë euro (30 €);
 - 1.4 Për panot reklamuese nga katër metër katror (4m²) deri në gjashtë metër katror (6m²) - tridhjetë e pesë euro (35 €);
 - 1.5 Për panot reklamuese nga gjashtë metër katror (6m²) deri në tetë metër katror (8m²) - pesëdhjetë euro (50 €); dhe
 - 1.6 Për panot mbi tetë metër katror (8m²) - tetëdhjetë (80 €) euro.
2. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese në hapësirën publike, paguan taksë mujore si në vijim:
 - 2.1 Për panot reklamuese në hapësirën publike në qytet – katër euro për metër katror (4.00 €/m²);
 - 2.2 Për panot reklamuese në hapësirën publike jashtë qytetit - dy euro për metër katror (2.00 €/m²);
 - 2.3 Panot reklamuese elektrike/elektronike taksohen 30% më shumë nga shuma e përcaktuar nga paragrafi dy (2), pika një (1) dhe dy (2).
3. Llogaritja e taksës sipas paragrafit 2 të këtij neni bëhet duke shumëzuar totalin e madhësisë së panos reklamuese me taksën komunale mujore.
4. Çdo shoqëri tregtare obligohet që të njoftojë Komunën për vendosjen e një panoje sipas dispozitave të këtij neni, përveç atyre të paraparë në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1 i këtij neni, brenda gjashtëdhjetë (60) dite nga data e vendosjes, duke specifikuar llojin dhe madhësinë e panos së vendosur. Ndërsa paragrafi 2 i nënshtrohet paraprakisht procedurës së rregulluar me Rregulloren mbi dhënien në shfrytëzim për më pak se një vit të Pronës Komunale.
5. Nga taksa përjashtohen rastet e mbulimit të kantierit të ndërtimit ose renovimit të objektit (mbulimi). Për marrjen e pëlqimit për mbulim të kantierit ose renovimit të hapësirës së punës, pronari duhet të marr pëlqimin duke e përcaktuar kohën. Nuk përjashtohen nga taksa, pronarët që vendosin pano reklamuese në objektet në ndërtim dhe renovim që kanë të bëjnë me reklamimin: për shitje të banesave dhe objekteve tjera afariste.
6. Pagesa e taksës komunale për vendosjen e panove sipas këtij neni bëhet si në vijim:
 - 6.1 Për panot e vendosura sipas paragrafit 1 të këtij neni, pagesa vjetore bëhet deri me datë tridhjetë (30) shtator të vitit aktual dhe
 - 6.2 Për panot e vendosura sipas paragrafit 2 të këtij neni, pagesa bëhet para datës së vendosjes së panos.
7. Objektet që nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore, tarifa e tyre do të përcaktohet nga organi kompetent që lëshon pëlqimin për vendosjen e tyre në hapësirat publike. Kjo tarifë do të jetë ekuivalente me lartësinë e çmimit të objekteve që janë të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 25
Taksa komunale mbi parkimin e automjeteve

1. Çdo person që shfrytëzon hapësirat komunale të destinuara për parkim të veturave, paguan taksë komunale sipas dispozitave të këtij neni.
2. Taksa komunale për parkimin e automjeteve paguhet si taksë mujore ose si taksë për shfrytëzimin përkohshëm (me orë qëndrimi të veturës).
3. Taksa komunale mujore për parkimin e automjeteve në hapësirat publike është si në vijim:
 - 3.1 Për personat juridik në Zonën I – njëzet euro (20 €);
 - 3.2 Për personat fizik në Zonën I – dhjetë euro (10 €);
 - 3.3 Për personat juridik në Zonën II – dhjetë euro (10 €);
 - 3.4 Për personat fizik në Zonën II – shtatë euro (7 €);
4. Taksa komunale për parkim të përkohshëm për qëllim të ngarkimit apo shkarkimit të mallrave është dhjetë (10 €) në muaj.
5. Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të parkingut komunal është si në vijim:
 - 5.1 Për personat juridik në Zonën I – pesëdhjetë cent (0.50 €) në orë;
 - 5.2 Për personat fizik në Zonën I – dyzetë cent (0.40 €) në orë;
 - 5.3 Për personat juridik në Zonën II – dyzetë cent (0.40 €) në orë;
 - 5.4 Për personat fizik në Zonën II – tridhjetë cent (0.30 €) në orë
6. Pagesa sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni bëhet në baza mujore apo për më shumë muaj, pas marrjes së pëlqimit nga organi përkatës komunal. Pagesa sipas paragrafit 5 të këtij neni bëhet pas marrjes së shërbimit.

Neni 26
Taksa komunale për vendosjen e përkohshme të objekteve të ndryshme në hapësirat publike

1. Çdo person që vendos objekte të ndryshme në hapësirat publike, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 1.1 Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën I – dhjetë euro për një metër katror (10 €/m²) në muaj;
 - 1.2 Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën II – tetë euro për një metër katror (8 €/m²) në muaj;
 - 1.3 Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën III – gjashtë euro për një metër katror (6 €/m²) në muaj;
 - 1.4 Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën I – tetë euro për një metër katror (8 €/m²) në muaj;
 - 1.5 Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën II – gjashtë euro për një metër katror (6 €/m²) në muaj;
 - 1.6 Vendosja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën III – katër euro për një metër katror (4 €/m²) në muaj;
 - 1.7 Vendosja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën I – pesëmbëdhjetë euro për një metër katror (15 €/m²) në muaj;
 - 1.8 Vendosja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën II – dhjetë euro për një metër katror (10 €/m²) në muaj;
 - 1.9 Vendosja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën III – pesë euro për një metër katror (5 €/m²) në muaj;
 - 1.10 Vendosja e shtandeve të hapura për shitjen e librave jo shkollor për veprimtari ekonomike në Zonën I – njëzetë euro (20 €) në muaj;
 - 1.11 Vendosja e shtandeve të hapura për shitjen e librave jo shkollor për veprimtari ekonomike në Zonën II – pesëmbëdhjetë euro (15 €) në muaj;
 - 1.12 Vendosja e shtandeve të hapura për shitjen e librave jo shkollor për veprimtari ekonomike në Zonën III – dhjetë euro (10 €) në muaj;

- 1.13 Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën I – pesëmbëdhjetë euro (15 €) në muaj;
 - 1.14 Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën II – dhjetë euro (10 €) në muaj;
 - 1.15 Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën III – tetë euro (8 €) në muaj;
 - 1.16 Vendorsja e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë – tridhjetë (30 €) në muaj;
 - 1.17 Vendorsja e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm – tetë euro për një metër në katror për (8 €/m²) në muaj;
 - 1.18 Vendorsjen e lojërave të fëmijëve – tre euro për një metër në katror (3 €/ m²) në muaj;
 - 1.19 Vendorsja e gjeneratorëve statik – gjashtë euro për një metër në katror (6 €/m²) në muaj;
 - 1.20 Vendorsja e veturave për qëllime komerciale – njëzetë euro (20 €) në muaj.
 - 1.21 Vendorsja e lojërave argëtuese – njëzetë euro (20 €) në muaj.
 - 1.22 Vendorsja e kabllave të ndryshme në hapësirë për qëllime komerciale private – njëqind euro (100 €) në vit;
 - 1.23 Vendorsja e kabllave të ndryshme nëntokësore për qëllime komerciale private – treqind euro (300 €) në vit;
 - 1.24 Vendorsja e ormanëve apo pasjeve tjera shpërndarës – njëqind euro (100 €) në vit;
 - 1.25 Vendorsja e foltoreve telefonike – njëqindpesëdhjetë euro (150 €) në vit;
 - 1.26 Vendorsja e antenave telekomunikuese – treqind euro (300 €) në vit;
2. Objektet që nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore, tarifa e tyre do të përcaktohet nga organi kompetent që lëshon pëlqimin për vendosjen e tyre në hapësirat publike. Kjo tarifë do të jetë ekuivalente me lartësinë e çmimit të objekteve që janë të përcaktuara me këtë rregullore.
 3. Institucionet publike dhe Organizatat jo qeveritare (OJQ) për vendosjen e objekteve të përkohshme në hapësirat publike dhe për shfrytëzimin e hapësirës publike deri në dhjetë ditë, pas dhënies së pëlqimit nga organet kompetente për zhvillimin e aktiviteteve në interes të përgjithshëm, lirohen nga taksat e përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 27

Taksa komunale për regjistrimin e auto-taksive dhe linjave të transportit rrugor për udhëtarë

1. Regjistrimi për lejen e punës për auto-taxi – pesëdhjetë (50.00 €);
2. Vazhdimi i regjistrimit të lejeve për auto-taxi- dhjetë (10.00 €);
3. Regjistrimi dhe vazhdimi i linjave të transportit rrugor për udhëtar në trafikun urban dhe rural- dyzet (40. 00 €).

Neni 28

Taksa komunale për zhvendosjen dhe qëndrimin e veturave të përjashtuara nga trafiku rrugor në parkingun e Komunës

1. Çdo person, të cilit i zhvendoset – bartet mjeti si pasojë e përjashtimit nga trafiku rrugor, paguan taksa si në vijim:
 - 1.1 Zhvendosja e motoçikletës, traktorit pa mjet bashkangjites, veturë dhe mjetet transportuese nën 3.5 ton, brenda qytetit deri në vendin për vendosje dhe qëndrimin e tyre deri në 24 orë – tridhjetë (30 €);
 - 1.2 Tërheqja e mjetit transportues mbi 3.5 ton, rimorkios ose gjysmë-rimorkios dhe autobusit brenda qytetit deri në vendin për vendosje dhe qëndrimin e tyre deri në 24 orë – njëqind (100 €);
 - 1.3 Zhvendosja e mjeteve nga pika 1.1. të këtij neni nga zonat jashtë qytetit, pa ngarkesë është (0.25 €) për një kilometër (km), ndërsa me ngarkesë (0.50 €) për km.

- 1.4 Zhvendosja e mjeteve nga pika 1.2. të këtij neni nga zona jashtë qytetit pa ngarkesë është (0.25 €) për një kilometër (km), ndërsa me ngarkesë (0.50 €) për km.
2. Në rastin kur zhvendosja e automjetit vetëm fillon por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e qëndrimit, përcaktohen shumatat si në vijim:
 - 2.1 Për të gjitha mjetet në zonën urbane - pesëmbëdhjetë (15.00 €)
 - 2.2 Për të gjitha mjetet jashtë zonës urbane- tridhjetë (30.00 €);
3. Në rastet kur çdo automjet i zhvendosur, pas kalimit të kohës prej 24 orësh, nuk merret nga pronari ose shfrytëzuesi, ruajtja apo qëndrimi i mjetit, për një ditë qëndrimi paguhet çmimi prej pesë (5.00 €).

Neni 29

Taksa komunale për bllokimin e rrugëve dhe trotuareve

Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e rrugëve brenda territorit të Komunës, paguan taksat si në vijim:

1. Bllokimi i rrugës nga personat fizik dhe juridik për orë – dyzet euro (40€/h);
2. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e pjesshëm të rrugëve brenda territorit të Komunës, paguan taksat ditore në vlerë prej dhjetë euro (10€/h).
3. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e pjesshëm të trotuarit për qëllim të ndërtimit apo të ngjashme, paguan taksat ditore në vlerë prej tre euro (3€/h).
4. Pagesa e taksës sipas paragrafit një (1), dy (2) dhe tre (3) të këtij neni paguhet para bllokimit të rrugës apo trotuarit.

Neni 30

Taksa komunale për qarkullimin e automjeteve të rënda motorike në rrugët ku është ndaluar qarkullimi i automjeteve

1. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse për qarkullimin e automjeteve të rënda mbi 3.5 ton në rrugët ku është i ndaluar qarkullimi i tyre paguan taksa si në vijim:
 - 1.1 Leje për qarkullim me afat nga një (1) deri në tre (3) ditë - dhjetë (10.00 €);
 - 1.2 Leje për qarkullim në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh - pesëmbëdhjetë (15.00 €)
 - 1.3 Leje për qarkullim në afat prej një (1) muaj - tridhjetë (30.00 €)
2. Pagesa e kësaj takse sipas paragrafit një (1) të këtij neni paguhet para lëshimit të lejes për qarkullim të automjeteve të rënda mbi 3.5 ton.

Neni 31

Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale

1. Çdo person që shfrytëzon objektet e brendshme dhe hapësirat e jashtme komunale për qëllime komerciale apo për qëllime tjera, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 1.1 Salla e madhe e sporteve për klubet sportive, shkollat dhe OJQ'të që punojnë në rritjen e interesimit për sporte.– dhjetë euro (10 €/h) për një orë;
 - 1.2 Salla e madhe e sporteve, për rekreacion – njëzetë euro (20 €/h) për një orë;
 - 1.3 Trim kabineti për: klubet sportive, shkollat dhe OJQ'të që punojnë në rritjen e interesimit për sporte.– dhjetë euro (10 €/h) për një orë;
 - 1.4 Trim kabineti për rekreacion – një euro për person (1 €/h) për një orë;
 - 1.5 Trim kabineti për rekreacion-njëzet euro për person (20 €/muaj) për një muaj;

- 1.6 Mbajtja e tubimeve – Salla e Madhe-dyqind euro (200 €) Kohëzgjatje deri në 4 orë;
- 1.7 Mbajtja e tubimeve – Salla e Madhe-Treqindepesëdhjetë euro (350 €)/1ditë;
- 1.8 Mbajtja e Tubimeve Elektorale – Salla e Madhe-Katërqind euro (400 €)/1ditë;
- 1.9 Mbajtja e Koncerteve – Salla e Madhe- Pesëqind euro (500 €)/1ditë;
- 1.10 Zhvillimi i garave (ndeshjeve sportive)- njëqind euro (100 €) Kohëzgjatje deri në 3 orë;
- 1.11 Zhvillimi i garave (ndeshjeve sportive)-njëqindepesëdhjetë euro (150 €) Kohëzgjatje deri në 5 orë;
- 1.12 Zhvillimi i garave (ndeshjeve sportive)-dyqind euro (200 €) / 1 ditë;
- 1.13 Mbajtja e koncertit- dyqind euro (200 €) Kohëzgjatje deri në 2 orë
- 1.14 Mbajtja e koncertit- treqind euro (300 €) Kohëzgjatje deri në 4 orë;
- 1.15 Fusha e futbollit për rekreacion 1/1 (pa ndriçim)- njëzetë euro (20 €/h) për një orë;
- 1.16 Fusha e futbollit për rekreacion 1/2 (pa ndriçim)- pesëmbëdhjetë euro (15 €/h) për një orë;
- 1.17 Fusha e futbollit për shfrytëzimin e shkollave të futbollit- dhjetë euro (10 €/h) për një orë;
- 1.18 Fusha e futbollit për shfrytëzimin e shkollave të futbollit të cilat nuk janë pjesë e garave rajonale- njëzet euro (20 €/h) për një orë;
- 1.19 Fusha e futbollit me ndriçim 1/1 – tridhjetë euro (30 €/h) për një orë;
2. Shfrytëzimi i hapësirave të brendshme të Pallatit të Sporteve për reklamim
- 2.1 Hapësira në madhësinë prej 3.5m x 0.40m-njëqindepesëdhjetë euro (150 €) për një vit;
- 2.2 Hapësira në madhësinë prej 7m x 0.40m- treqind euro (300 €) për një vit;
3. Shfrytëzimi i hapësirave të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi”, “Galeria e Arteve”, Biblioteka Publike “Ibrahim Rugova”, Salla “Teki Dervishi”.

Shfrytëzimi i hapësirave të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi”					
	Përshkrimi	Salla Univerzale	Salla Solemne	Salla e leximit	Hapësira e Foajes
3.1.	Koncert – Shkolla Fillore dhe të Mesme (3 orë)	150.00	n/a	n/a	100.00
3.2.	Koncert – Shkolla Fillore dhe të Mesme (mbi 3 orë)	200.00	n/a	n/a	100.00
3.3.	Koncertet komerciale	350.00	n/a	n/a	n/a
3.4.	Debate, promovime, puntori (4 orë)	150.00	100.00	30.00	100.00
3.5.	Debate, promovime, punëtori me përmbajtje ushqimore (4 orë)	n/a	200.00	n/a	n/a
3.6.	Shfaqje teatrale	200.00 (100% e biletave)	n/a	n/a	0.00
3.7.	Shfaqje fëmijësh kukullash	30% e biletave	n/a	n/a	0.00
3.8.	Grupet amatore një orë provat	20.00	10.00	10.00	10.00
3.9.	Shfrytëzimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin Cërmjan	1 Ditë			20.00

3.10.	Shfrytëzimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin Bishtazhin	1 Ditë	20.00
-------	--	--------	-------

Galeria e Arteve			
3.11.	Debate, promovime, mbledhje	1 Ditë	50.00
3.12.	Ekspozita / Hapja zyrtare për ekspozitë	Hapja zyrtare për ekspozitë	50.00
3.13.	Promovime, qëllime komerciale	1 Ditë	100.00
3.14.	Trajnime / Punëtori	1 Ditë	50.00

Shfrytëzimi i hapësirave të objektit të bibliotekës së qytetit për shfrytëzim nga subjektet tjera fitimprurëse dhe jo-fitimprurëse (që nuk i takojnë institucioneve publike)

3.15.	Sallat e leximit për takime, puntori, debate, trajnim, prezente	Kohëzgjatja nën 4 orë	20.00
3.16.	Sallat e leximit për takime, puntori, debate, trajnim	1 ditë	30.00
3.17.	Salla e leximit për shfrytëzim nga shkollat private fillore, të mesme, universitetet, kolegjet (diplomimet, garat e dijes, etj)	Kohëzgjatja nën 4 orë	20.00
3.18.	Salla e leximit për shfrytëzim nga shkollat private fillore, të mesme, universitetet, kolegjet (për provime)	1 ditë	40.00
Shfrytëzimi i hapësirave në sallën "Teki Dervishi"			
3.19.	Trajnime / Punëtori	1 ditë	20.00
3.20.	Qëllime komerciale (incizimi i spoteve, etj)	1 ditë	100.00
3.21.	Ekspozita	1 ditë	50.00
3.22.	Promovime, mbledhje, debate	1 ditë	20.00
3.23.	Shfaqje	1 ditë	20.00

4. Shfrytëzimi i hapësirave të muzeve (Muzeu Etnologjik, Muzeu Historik, Muzeu i Muzikës)

Shfrytëzimi i hapësirave të muzeve (Muzeu Etnologjik, Muzeu Historik, Muzeu i Muzikës)			
4.1.	Trajnime / Punëtori	1 ditë	50.00

4.2.	Qëllime komerciale (incizimi i spoteve, etj)	1 ditë	100.00
4.3.	Ekspozita	hapja solemne + 10 ditë	50.00
4.4.	Taksa për vizitë Muzeut	Taksë individuale	1.00
4.5.	Taksa për vizitë Muzeut	Grupet mbi 5 persona	60% e taksës individuale

Neni 32

Shfrytëzimi i hapësirave të institucioneve arsimore

1. Taksa komunale për shfrytëzimin e hapësirave së brendshme dhe të jashtme të objekteve institucioneve arsimore si vijon:
 - 1.1 Salla e edukatës fizike për shfrytëzim nga shkollat private fillore, të mesme, universitetet, kolegjet (provimet, garat e dijes, etj)- pesëdhjetë euro (50 €) për një ditë;
 - 1.2 Salla e edukatës fizike për rekreacion- pesëmbëdhjetë euro (15 €) për një ditë;
 - 1.3 Fusha për hendboll, basketboll, volejbol – pesë euro (5 €) për një orë; Fusha për futboll (me bar artificial) – dhjetë euro (10 €) për një orë;
 - 1.4 Fusha për futboll (e asfaltuar) – pesë euro (5 €) për një orë;
 - 1.5 Koncerte komerciale – njëqindpesëdhjetë euro (150 €) kohëzgjatja deri në 2 orë;
 - 1.6 Tubime, Promovime, Debate – shtatëdhjetë euro (70 €) kohëzgjatja nën 2 orë;
 - 1.7 Konferenca - shtatëdhjetë euro (70 €) kohëzgjatja nën 2 orë;
 - 1.8 Galeria e shkollës - pesëdhjetë euro (50 €) kohëzgjatja nën 2 orë;
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shfrytëzimi i objekteve komunale për qëllime edukative, arsimore, shkencore dhe për qëllim të ngjashme sociale është i liruar nga pagesa.
3. Pagesa e taksës komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale sipas paragrafit një (1) të këtij neni bëhet para marrjes në shfrytëzim të objektit.

Neni 33

Taksa komunale për shfrytëzimin afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

1. Të gjithë personat që marrin në shfrytëzim pronën komunale në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, varësisht nga lloji i pronës së paluajtshme dhe klasifikimi, paguajnë taksë komunale mujore apo vjetore të shfrytëzimit, sipas kontratës përkatëse të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale.

Neni 34

Taksat administrative dhe komunale në institucionet publike

1. Taksa administrative në institucionet arsimore është si vijon:
 - 1.1 Duplikati i dëftesës së institucionit të arsimit – pesë euro (5 €);
 - 1.2 Duplikati i diplomës së institucionit të arsimit – pesë euro (5 €);
 - 1.3 Regjistrimi i vitit (1 vit)- njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
 - 1.4 Praktika profesionale – pesëdhjetë euro (50€);
 - 1.5 Provimi diferencial – dhjetë euro (10€);
 - 1.6 Provimet përfundimtare të klasës, certifikata – tridhjetë euro (30€)
 - 1.7 Diploma e përfundimit të shkollimit – njëzet euro (20€);
 - 1.8 Provimi i klasës (paraqitja e provimit të klasës) – njëzet euro (20€);
 - 1.9 Provimi i lëndës (paraqitja e një lënde) – tre euro (3€);

- 1.10 Provimi i Diplomës (paraqitja e provimit) – dyzet euro (40€);
 1.11 Për qëndrim ditor të fëmijëve në çerdhe - dyzetepesë euro (45 €);
 1.12 Paguesa për akomodim të nxënësve dhe studentëve në konvikt – shtatëdhjetë euro (70€);

Neni 35
Tarifat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor

Nr	Lloji i Shërbimit - Mjekësi Familjare	Çmimi €
1	Ekzaminimi mjekësor në AMF, QMF ose QKMF, pa analiza Laboratorike dhe pa procedurë plotësuese diagnostike me aparaturë	€ 1.00
2	Ekzaminimi specialistik në QKMF, QMF ose AMF me udhëzim të mjekut familjar	€ 2.00
3	Ekzaminimi specialistik në QKMF, QMF ose AMF pa udhëzim të mjekut familjar	€ 5.00
4	Ekzaminimi ose vizitë shtëpiake përpos në raste emergjente	€ 6.00
5	Medikamente nga lista esenciale e ofruar në barnatoren e QKMF-së	€ 0.30
6	Ultrazëri standard	€ 2.00
7	Radiografia	€ 2.00
8	EKG	€ 0.50
9	Analizat Laboratorike - vetëm Hemogrami dhe Urina	€ 1.00
10	Analizat Laboratorike komplet në laboratorin hematologjik	€ 3.00
11	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër	€ 1.00
12	Caktimi i sheqerit tre mujorshi (HBA1C)	€ 3.00
13	Testimi serologjik për COVID	€ 2.00
14	Testimi rapid për COVID	€ 2.00
15	Audiogrami	€ 1.00
16	Shpëlarja e veshit	€ 1.00
17	Dhënia e injeksionit në QKMF, QMF dhe AMF	€ 0.30
18	Dhënia e injeksionit nga vizita mjekësore e kryer jashtë QKMF, QMF dhe AMF	€ 1.00
19	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi përpos rasteve emergjente	€ 1.00
20	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi përpos rasteve emergjente	€ 1.00
21	Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë)	€ 3.00
22	Inhalimi në QKMF,QMF dhe AMF	€ 0.50
23	Ekzaminimi mjekësor në Urgjencë pas orës 22:00 deri 07:00 (përveç rasteve emergjente)	€ 2.00
24	Certifikatë mjekësore për lejen e vozitjes (A1,A,B1,B,BE,M,L dhe T) të lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve	€ 20.00
25	Certifikatë mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore	€ 15.00
26	Dhënia e raportit mjekësor, vërtetim apo dokument tjetër sipas kërkesës së pacientit	€ 5.00
27	Ofrim i shërbimit shëndetësor së bashku me Autoambulancë gjatë aktiviteteve sportive etj, për një orë	€ 25.00

Lloji i Shërbimit - Stomatologji

1	Vizita e parë stomatologjike	€ 1.00
2	RTG i dhëmbit	€ 1.50
3	Mbushja e përhershme me amalgam	€ 4.00
4	Mbushja e përhershme me kompozitë	€ 5.00
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 5.00
6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
7	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
9	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
10	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
11	Rindërtimi Konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	€ 6.00
12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	€ 1.00
13	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	€ 1.00
14	Vulosja e fisurave	€ 1.00
15	Mënjanimi i depozitimeve të buta	€ 1.00
16	Mënjanimi i depozitave të forta (heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratratingull)	€ 3.00
17	Kiretazha e gjepave parodontal (një dhëmb)	€ 1.00
18	Nxjerrja e dhëmbit	€ 1.50
19	Incizioni intra dhe ekstra oral	€ 1.50
20	Heqja e kurorës me anë të prerjes	€ 1.00
21	Riparimi i protezës (ngjitja)	€ 1.50

Lloji i Shërbimit - Stomatologjike - Specialistik

1	Vizita e parë stomatologjike	€ 1.50
2	RTG ortopantomogrami	€ 3.00
3	Mbushja e përhershme me amalgam	€ 4.00
4	Mbushja e përhershme me kompozitë	€ 5.00
5	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
6	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
7	Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
8	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
9	Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
10	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	€ 6.00
11	Rindërtimi Konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	€ 8.00
12	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	€ 1.00
13	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	€ 1.00

14	Vulosja e fisurave	€	1.00
15	Mënjanimi i deopozitimeve të buta	€	1.00
16	Mënjanimi i depozitave të forta (heqja e gurëzëve të dhëmbëve me ultratingull)	€	4.00
17	Kiritazha e gjepave parodontal (një dhëmb)	€	1.00
18	Nxjerrja dhëmbit	€	1.50
19	Nxjerrja dhëmbit në mënyrë operative	€	4.00
20	Nivelimi i zgjatimit alveolare	€	6.00
21	Incizioni intra dhe ekstra oral	€	1.50
22	Apikotomia	€	12.00
23	Frenektomia	€	2.00
24	Trajtimi kirurgjiko-paraprotetikor (ndërhyrja lokale operative në indet e forta dhe të buta)	€	8.00
25	Heqja e kurorës me anë të prerjes	€	1.50
26	Riparimi i protezës (ngjitja)	€	2.00
27	Zëvendësimi i dhëmbit të humbur në protezë (deri në tre dhëmbë)	€	3.00
28	Ribazimi direkt apo indirekt i protezës	€	3.00
29	Aparati ortodontik aktiv	€	25.00
30	Riparimi i aparatit ortodontik	€	3.00

Kategoritë e liruar nga bashkëpagesat

1. Të liruar nga bashkëpagesat janë kategoritë që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Nga bashkëpagesat lirohen personat që autorizohen nga organet kompetente komunale për të ushtruar aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me komunën e Gjakovës.
3. Taksat e përcaktuara në këtë nen, nuk kanë fuqi juridike nëse me legjislacionin primar të aplikueshëm do të ndryshohen.

KAPITULLI IX GJOBAT LIDHUR ME TAKSAT KOMUNALE

Neni 36

Gjobat lidhur me mos paraqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo preson fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej njëzetë euro (20 €).
2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).

Neni 37
Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin

- 1.13 Çdo person fizik që ka vendbanim apo vendqëndrim në Komunë dhe i cili nuk i ndërmerr verimet e parapara në këtë paragraf, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej tetëdhjetë (80 €):
- 1.1 nuk e lajmëron ndryshimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit brenda territorit të komunës, brenda tetë (8) ditësh nga ky ndryshim;
- 1.2 nuk e lajmëron largimin nga Republika e Kosovës, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë; dhe
- 1.3 nuk e lajmëron kthimin në Republikën e Kosovës, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

Neni 38
Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).
2. Çdo shoqëri tregtare që nuk vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).

Neni 39
Gjobat lidhur mos pagesën e taksës komunale mbi mjetet motorike

1. Çdo person fizik i cili nuk e paguan taksën komunale për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej dhjetë euro (20 €).
2. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, e cila nuk e paguan taksën vetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej tridhjetë (40 €) euro.
3. Çdo shoqëri tregtare apo person tjetër juridik i cili nuk vepron si biznes individual, që nuk e paguan taksën vetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej njëqind euro (100 €).

Neni 40

Gjobat
për mos pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje sipas afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
- 1.1 për personin fizik – njëqind euro (100 €);
- 1.2 për personi fizik që ushtron biznes individual – dyqind euro (200 €); dhe
- 1.3 për personin juridik – treqind euro (300 €).

Neni 41

Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri i cili nuk paguan takës komunale mbi vendosjen e panove reklamuese e cila kalon vlerën prej njëqind euro (100 €) sipas afateve të përcaktuar nga kjo Rregullore kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1. Shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €); dhe
 - 1.2. Shoqëritë tregtare tjera – njëqind euro (100 €) euro.

Neni 42

Gjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve të në hapësirat publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, e cila kalon vlerën mbi njëqind euro (100 €), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1 Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €); dhe
 - 1.2 Shoqëritë tregtare tjera – njëqind euro (100€).

Neni 43

Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatore

1. Gjobat e përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre, por jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi i pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Presoni ndaj të cilit shqiptohet gjobë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet.

KAPITULLI X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 44

Taksat Qendrore

Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguara nga niveli qendror dhe mbledh taksë të përcaktuar nga ky nivel.

Neni 45 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja K.GJK 01-011-43964 për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, Rregullorja K.GJK. 01-110-85296 për Ndryshimin dhe Plotësimin e 011-43964 për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale si dhe Rregullorja 01-110/04-7431 për Plotsim Ndryshim Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale

Neni 46 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Gjakovës.



Arbënesha Kuqi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës